



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Leksikologji e Gjuhës B**

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti II , semestri 1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit studenti duhet: të arrijë të marrë njohuritë bazë të lëndës së leksikologjisë; të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara në analizën praktike që u bëhet proceseve leksiko-semantike; të pajiset me njohuri teorike mbi sistemin leksikor të gjuhës së sotme ruse (aspekte të studimit të leksikut, tipet e kuptimit leksikor të fjalës, grupet kryesore paradigmatiske, dhe tipet e lidhjeve sintagmatike të tyre), si edhe lidhur me diferencimin kohor dhe social të leksikut të gjuhës ruse; të pajiset me shprehje mbi analizën semantike të kuptimit leksikor të fjalës; të përvetësojë shprehjet e punës me fjalorë të ndryshëm (njëgjuhësh, dygjuhësh, etj.);

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të njohë se si të:

- të analizojë një fjalë nga ana semantike;
- të zhvillojë analizën leksikologjike të një teksti;
- të përdorë në praktikën vetjake gjuhësore leksikun e përvetësuar;
- të përdorë gjatë punës së tyre kërkimore-shkencore fjalorë të ndryshëm të leksikut të gjuhës ruse.

Rezultatet e pritshme:

1. Zotërimi i njohurive themelore mbi leksikologjinë: Studenti do të jetë në gjendje të njohë sistemin leksikor të gjuhës së sotme ruse dhe t'i analizojë proceset leksiko-semantike në mënyrë të planifikuar.
2. Aftësi për analizë semantike dhe leksikologjike: Studenti do të jetë në gjendje të analizojë kuptimin leksikor të një fjale dhe të zbatojë analiza leksikologjike në tekste të ndryshme.
3. Përdorimi praktik i leksikut të përvetësuar: Studenti do të demonstrojë aftësinë për të përdorur leksikun e përvetësuar në komunikim të përditshëm dhe në situata akademike.